



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 118 dt.30.07.1996

Këshilli Bashkiak, i mbledhur me dt.30.07.1996, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike,

VENDOSI

1. Të miratojë nga të ardhurat Bashkisë çeljen e fondit prej 12.000.000 lekë Ndërmarrjes së Kuartalleve për 4 mujorin e dytë të vitit 1996.
2. Të mirtojë çeljen e fondit prej 600.000 lekë Ndërmarrjes së Përpunimit të Plehut për të bërë pagesën e traktorit marrë në sektorin privat për punime në Sharrë.
3. Të miratojë çeljen e fondit prej 88.793.415 lireta për çdëmtimin e 50% të kostos të konteinerëve të humbura në firmën “Nuova Ecolega” sipas kapitullit A pika 3 të Kontratës midis saj dhe Bashkisë së Tiranës.
4. Të miratojë Këshillat Drejtues të Ndërmarrjes Përpunim Plehut dhe Ndërmarrjes Kuartalleve.
5. Të miratoj relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për realizimin e kërkesës së familjes dëshmorit Spartak Deliu për ndërtimin e varrit të tij në varrezat e Kombinatit. Ndërtimi do të bëhet nga

Ndërmarrja e Funeralit, duke ju bërë likujdimi sipas projekt preventivit të paraqitur nga ana e saj në përfundimin e punimeve.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet D.SH.Publike dhe D.A.Financiar.

KRYETARI

BESNIK PETRELA